



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 32/1 Prot.

Tiranë 29/07/2021

Lënda : Kthim përgjigje

AV. DORIAN MATLIJA
Drejtör Ekzekutiv, Qendra "Res Publica"
Blv. "Gjergj Fishta", Nd. 24, H. 3, Ap. 44

TIRANË

I nderuar z. Matlija,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit (AP) është administruar kërkesa për informacion e Qendrës Respublica nr. 108/21, regjistruar me nr. 32, datë 28.07.2021, lidhur me vlerësimet e kryera në terren nga institucioni i Avokatit të Popullit në lidhje me Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë për prishjen e pallateve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, në Njësinë Administrative nr.6, Kombinat. Bazuar në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ju bëjmë me dije si më poshtë vijon.

Një nga problematikat më shqetësuese të trajtuara nga Avokati i Popullit që nga viti 2019 e në vijim, ka qenë ajo e lidhur me pasojat që la pas tërmeti i datës 26.11.2019. Avokati i Popullit përgjatë kësaj periudhe ka vijuar të ndjekë me vëmendje shqetësimet e qytetarëve të prekur nga kjo fatkeqësi. Trajtimi i kësaj çështje ka qenë në vëmendjen e veçantë të institucionit tone që në momentet e para të fatkeqësisë natyrore. Kjo, e materializuar nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për verifikimin në terren të situatës, të cilët kanë qenë prezent dhe kanë inspektuar veprimtarinë e kryer nga institucionet përgjegjëse, menjëherë pas ngjarjes. Kjo vëmendje e institucionit tonë vërehet edhe në numrin e konsiderueshëm të çështjeve që kemi ndërmarrë me iniciativë gjatë vitit 2020 e në vijim, të cilat janë bërë publike në mediat e shkruara dhe ato vizive. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe kemi trajtuar edhe ankesat e adresuara nga shtetasit e prekur nga kjo fatkeqësi natyrore. Nga numri total i këtyre çështjeve të trajtuara nga institucioni ynë një pjesë e tyre vazhdojnë të jenë në proces hetimi administrativ, ndërsa pjesa tjetër janë mbyllur pasi objekt i tyre mund të ketë qenë bonusi i qirasë, i cili është akorduar gjatë hetimit administrativ apo problematika që kanë gjetur zgjidhje. Çështjet për të cilat vazhdon hetimi administrativ, janë në proces, pasi pritët përgjigja e institucioneve përgjegjëse të cilat nuk kanë kthyer përgjigje shteruese mbi problematikat e konstatuara. Lidhur me problematikat që kanë të bëjnë me pasojat e tërmetit, akoma vazhdojnë të paraqiten ankesa pranë institucionit tonë, si dhe të publikohen në media shqetësimet e qytetarëve mbi veprimtarinë e institucioneve përgjegjëse. Ankesat e paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit, si dhe ato të publikuara në media, konstatohet se kanë të bëjnë kryesisht me miratimin e bonusit të qirasë, strehimit të përshtatshëm, mungesën

e ndihmës nga institucionet shtetërore përgjegjëse, mospërfshirjen në fondin e rindërtimit si dhe mosqënien dakord me vlerësimin e kategorisë së dëmtimit të objekteve. Problematikat e lidhur me pasojat e shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 janë bërë edhe pjesë e raportit vjetor të institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë¹.

Lidhur me objektin e kërimit të kërkesës së depozituar nga ana juaj, sa i takon vlerësimeve të kryera në terren nga institucioni i Avokatit të Popullit në lidhje me Vendimet e Këshillit Bashkiak Tiranë për prishjen e pallateve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, në Njësinë Administrative nr.6, Kombinat, ju informojmë për rastin si më poshtë.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka administruar ankesën e banorëve të Pallatit nr. 153, Njësia Administrative Nr. 6 Kombinat, Tiranë të cilët kanë paraqitur shqetësimin mbi prishjen e pallatit të tyre nga ana e Bashkisë Tiranë pa u njoftuar më parë banorët për ndërhyrjen dhe pa asnjë akt administrativ lidhur me prishjen e pallatit. Ankuesit shprehen se në dt. 14.06.2021 në ambjentet e pallatit janë paraqitur inspektorë të IMT pranë Bashkisë Tiranë dhe kanë njoftuar gojarisht banorët dhe pronarët e njësive tregëtare për prishjen e pallatit pa paraqitur aktet administrative (vendim për prishje) konform Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "*Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme*". Marrë shkak nga ankesa e mësipërme, në interes të sqarimit dhe zgjidhjes së kësaj situate në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve ndaj veprimeve ose mosveprimeve të organeve të administratës publike, është kërkuar dhënia e shpjegimeve shoqëruar me dokumentacionin referues lidhur me zbatueshmërinë e dispozitave të Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 "*Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme*", gjatë procesit të prishjes së pallatit 153 Kombinat. Më datë 18.6.2021, ankuesit kanë njoftuar institucionin e Avokatit të Popullit se IKMT kishte filluar prishjen e pallatit që në orët e para të mëngjesit. Për këtë arsye dy ndihmëskomisionerë të Seksionit të Administratës kanë kryer një inspektim në terren për të verifikuar situatën, si edhe një takim në Njësinë Bashkiake nr. 6. Rasti në fjalë është ende në proces hetimi administrativ, në përfundim të të cilit do të njoftohen ankuesit për rezultatin, dhe nëse eventualisht do të evidentohen problematika në veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike ato do të adresohen nëpërmjet rekomandimeve apo raporteve të institucionit të Avokatit të Popullit, të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI
Prof.Asoc.Dr. **Erjona BANA (CANAJ)**

¹ Raporti vjetor gjendet i publikuar në faqen zyrtare të institucionit, në rubrikën "Botimet" – "Raporte Vjetore", link:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20Vjetor%20i%20veprimtarise%20se%20institucionit%20te%20Avokatit%20te%20Popullit%20-%20viti%202020.pdf>